



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:064298

Datë: 18.07.2019

Numri i dokumentit: 00416429

P.nr.739/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja Diana Sina, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.C. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve, nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP/IL.nr.1487/2018 të datës 17.10.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën **18.07.2019**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Mone Sylja, të akuzuarit, të Përfaqësuesit të autorizuar i të dëmtuarës K.-Distrikti në Gjakovë, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **E.C.**, i biri i H. dhe i ëmës S. e gjinisë Th., data e lindjes..., K.Malishevë, e tani me banim në Gjakovë, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, ka të kryer katër klasë të shkollës fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, pensioner, i martuar- atë i 6 fëmijëve, numër personal ...

Ë s h t ë f a j t o r e:

Sepse: Nga data e pavërtetuar e gjer me datën 11.06.2018 në shtëpinë e tij në Gjakovë, me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshëm, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Kosovës, në atë mënyrë që nga shikimi i njehsorit elektrik është konstatuar se ka anashkaluar njehsorin me nr..., përmes kabllos 3x2 mm në mënyrë ilegale në çatinë e shtëpisë, është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç' rast të dëmtuarës K.-divizioni në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 321.99 Euro.

- me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve, nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4, 17 par.1, 41, 49, 50, 51, 52 ,73, dhe nenit 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton;

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

E dëmtuara K. - Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1487/2018 të datës 17.10.2018, kundër të akuzuarit E.D. nga Gjakova, për shkak se ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së. duke propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

Prokurorja e shtetit pasi u njoftua nga vet i akuzuari se i njëjti është shfrytëzues i njehsorit elektrik me nr.... dhe pasi muarr në shiqim faturën e pagesës së K.- të dt.30.05.2019 dhe vërtetoi se i njëjti është shfrytëzues i këtij njehsori elektrik dhe pasi bëri shiqimin e lejes së njoftimit të tij atëherë bënë përmisimin e mbiemrit të tij ashtu që në vend të mbiemrit D. duhet të jetë C. dhe numri personal i tij është ..., ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

Prokurori i shtetit pasi lexoi aktakuzën bënë rikualifikimin e veprës penale komfor nenit 3 të KPRK-së, duke marr parasysh se vepra penale është kryer në mes të datës së pavërtetuar e gjerë me dt.11.06.2018 kohën në të cilën ka qenë në fuqi kodi penal i Republikës së Kosovës, nr.04/L-082, me dt.14.04.2019 ka hyrë në fuqi Kodi penal i Republikës së Kosovës, me nr.06/L-074 me të cilën është shfuqizuar kodi penal 04/l-082, kodi penal i rij me nenin 314 ka përcaktuar veprën penale vjedhje e shërbimeve për të cilën veprë përcaktohet dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri në 3 vjet, për dallim nga kodi i vjetër përcaktohet dënim komulativë përkatësisht gjobë dhe dënim me burg deri në 3 vjet, duke marr parasysh faktin se në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqyrtimit të vendimit të formës së prerë atëherë ndaj kryesit të veprës penale zbatohet ligji që është më i favorshëm dhe duke u mbështetur në këtë parim, i cili është i përcaktuar me nenin 3 të KPRK-së, nr.06/L-074 atëherë bëjë kualifikimin nga neni 320 në nenin 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sepse është më i favorshëm për të akuzuarin, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari E.C. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaron, se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, për të cilën veprë jam penduar pa masë dhe premtoi para gjykatës se një veprë të tillë nuk do ta përsëris, tani e shfrytëzoi në mënyrë të rregullt rrymën elektrike, jam pagues i rregullt i shpenzimeve të energjisë elektrike, shton se jam mbajtës i vetëm i familjes si dhe për herë të parë paraqitem në Gjykatë për një veprë të kryer penale por premtoi se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoi gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ti merr parasysh rrethanat e lartë cekura dhe të më shqiptoi një dënim më të butë.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës K.-Distrikti në Gjakovë, A.K. deklaron, se nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit E.C. i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe kompensimin e dëmit do ta realizoi në kontest civil, i njëjti si provë ia prezanton gjykatës transaksionin e konsumatorit me nr...me numër të njehsorit... të dt.18.07.2019.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari E.C.: Nga data e pavërtetuar e gjer me datën 11.06.2018 në shtëpinë e tij në Gjakovë, me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshëm, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Kosovës, në atë mënyrë që nga shikimi i njehsorit elektrik është konstatuar se ka anashkaluar njehsorin me nr...., përmes kabllor 3x2 mm në mënyrë ilegale në çatinë e shtëpisë, është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç' rast të dëmtuarës K.-divizioni në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 321.99 Euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimin, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: gjendjen e varfër ekonomike, është baba i 6 fëmijëve, është mbajtës i vetëm i familjes, pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, sjelljet korrekte në gjykim, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, Gjykata e mori në mbështetje të nenit 453 par.4 të KPPK-së, nga se detyrimi që ti paguaj

shpenzimet procedurale do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe personave që ata detyrohen të mbështesin materialisht.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.739/18 me datën 18.07.20219

Procesmbajtësja,
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:064298
Datë: 18.07.2019
Numri i dokumentit: 00416429